



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:282948

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05638466

Ac.nr.3926/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarja Nora Bllaca-Dula, kryetare e kolegjit, Halide Reka dhe Ylber Shurdhiqi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.Xh nga P....., punëtor i PK, Sh.A, njësia punuese në Pejë, të cilin e përfaqëson me autorizim avokati H.N, kundër të paditurës PK Sh.A, P....., njësia punuese në Pejë, e përfaqësuar nga i autorizuari E.A, me bazë juridike kompensim i dëmit material, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë–Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1494/19, i datës 08.04.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 25.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës PK Sh.A, P....., njësia punuese në P....., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë–Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1494/19, i datës 08.04.2021 në pikën I, II dhe IV të dispozitivit të aktgjykimit, VËRTETOHET.

II. Mbetet e pashqyrtuar pika III e dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, në pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.1494/19, i datës 08.04.2021, ka vendosur: “ *APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.Xh nga P....., punëtor i PK, Sh.A, njësia punuese në P..., kundër të paditurës PK Sh.A, P....., Njësia Punuese në P.....*

I. DETYROHET e paditura PK Sh.A në Prishtinë, që paditësit A.Xh nga P....., që në emër të kompensimit të dëmit material për periudhën kohore prej 03.12.2016 e deri më 03.12.2019, t'ia paguaj diferencën e pagave në mes të vendit të punës se sportelistit me gradë 5 dhe vendit të punës së kontrollorit të postierëve me gradë 6, shumen prej 2,507,34 €, dhe atë në kamatë ligjore prej 8% në vit nga data 08.04.2021, (nga dita e përpilimit të aktgjykimit), e deri në pagesën definitive, dhe kamatën e llogaritur nga data 03.12.2016 e deri me datën 17.02.2021, në shumen prej 551,60 €, apo në shume të përgjithshme prej 3,058,94 €. E të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi e nen kërcënim e përmbarimit të dhunshëm.

II. DETYROHET e paditura PK Sh.A, P....., njësia punuese në Pejë që paditësit A.Xh nga P....., punëtor i PK, Sh.A, P....., Njësia punuese në Pejë, që në emër të kontributit pensional t'ia paguaj shumën prej 146,63 €, për tatimin në burim 278.59 € dhe të refundoj shumën prej 146.63 € në Fondin e Trusti Pensional në të mirë të paditësit.

III. REFUZOHET pjesërisht kërkesa e paditësit A.Gj kundër të paditurës PK Sh.A, P....., përtej shumës së gjykuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë për shumen prej 332.66 €, si e pa bazuar.

IV. DETYROHET e paditura PK, Sh.A, P....., Njësia punuese në P....., që paditësit t'i kompenzoj shpenzimet procedurale në shumë prej 804 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin të përmbarimit të detyrueshëm”.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura, përmes të autorizuarit të saj, në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe shkeljeve qenësore të dispozitave të procedurës, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e të paditurës dhe të priset aktgjykimi i atakuar dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje ose që të ndryshohet aktgjykimi dhe të refuzohet kërkesëpadia e paditësit.

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, ka paraqitur përgjigje në ankesën e të paditurës, duke i kundërshtuar pretendimet ankimore, me propozim Gjykatës së Apelit, që ankesën ta refuzojë, ndërsa aktgjykimin e atakuar ta vërtetojë.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, përmes të autorizuarit të tij, me datën 03.12.2019, ka ushtruar padi pranë gjykatës së shkallës së parë, kundër të paditurës për shkak të kompensimit të dëmit material nga marrëdhënia e punës në vlerën prej 3.840 €, ndërsa me datën 12.03.2021 përmes parashtrësës së precizuar ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit duke e detyruar të paditurën që të kompensojë dëmin material për periudhën kohore prej datës 03.12.2016 deri me datën 03.12.2019 për diferencën e pagës në mes të vendeve të punës sportelist grada V dhe vendit të punës të kontrollorit të postierëve grada VI, t'ia paguajë paditësit shumën prej 2840 € me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga dita e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive dhe atë për diferencën e pagave neto të papaguara në shumën prej 2.507,34 € me kamatën e llogaritur deri me datën 18.02.2021 në shumën prej 551.60 € apo shumën e

përgjithshme prej 3.058, 94 €, në emër të kontributit pensional shumë prej 146.63 €, për tatimin në burim 278.59 € dhe të refundojë shumë prej 146.63 € në fondin e Trustit Pensional në të mirë të paditësit të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë, si dhe shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas padisë së paditësit, precizimit të kërkesëpadisë, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor dhe pas administrimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, ka marrë aktvendimin C.nr.1494/19 të datës 08.04.2021, me të cilin e aprovon pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, e duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se paditësi sipas kontratës së punës për kohë të pacaktuar me numër 01-5-549/12 e datës 20.07.2012, ka themeluar marrëdhënie pune me të paditurën Posta e Kosovës, me detyrat e punës si Punëtor Sporteli në lokacionin Pejë, me orar të plotë, me pagën bazë sipas gradës 5. Me kontratën e datës 31.12.2020, me nr.01-2450/20 paditësi me të paditurin kanë lidhur kontratë për pozitën Kontrollor të Shpërndarjes në PK Sh.A. Me email-in e datës 06.08.2014 të dërguar nga B.G, Menaxhere e Postave Regjionale – P....., e cila ka propozuar që paditësi të caktohet në pozitën e kontrollorit të postierëve me qëllim që të mos këtë parregullsi në këtë dikaster, pasi që ish punëtori Y.T ka dalë në pension dhe detyrën e tij është duke e ushtruar koordinatori i shpërndarjes A.Gj. Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar në bazë të email-it të datës 06.08.2014 të dërguar nga B.G dërguar B.G, S.D, A.Gj, D.Sh dhe A.Gj. Me email-in e datës 29.04.2016 dërguar nga K.C, Menaxher i Postave Regjionale – P....., ka njoftuar punëtorët se Komisioni pas shqyrtimit të statusit juridik, kontraktual dhe operativ të stafit të PK Sh.A në të gjitha regjionet në PK, se ju ka ndërruar pozita disa punëtorëve, e në mesin e tyre ceket se paditësi është Kontrollor i Shpërndarjes ZK-P..... Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar në bazë të e-mailit të datës 29.04.2019. Me email-in e datës 28.11.2019 Menaxheri regjional – P....., E.F, ka njoftuar S.D se paditësi prej 5 vitesh është duke e ushtruar detyrën e Kontrollorit të Shpërndarjes dhe ka kërkuar nga i njëjti që personi në fjalë të emërohet si U.D i Kontrollorit të Shpërndarjes deri në risistemimin e tij të plotë. Paditësi ka kërkuar në vazhdimësi nga e paditura që të trajtohet barabartë si të gjithë punëtorët e tjerë, që të risistemohet dhe t'i lëshohet kontrata e punës si U.D i kontrollorit të shpërndarjes, si dhe të paguhet me gradën 6, por nuk ka marrë asnjëherë përgjigje nga e paditura dhe kjo vërtetohet nga kërkesat e vazhdueshme të menaxherit të postës regjionale në P..... K.C dhe E.F, përmes emailave të lartcekura.

Në bazë të legjislacionit në fuqi, paditësi ka themeluar marrëdhënie pune me të paditurën sipas kontratës së punës për kohë të pacaktuar me datën 20.07.2012, si Punëtor Sporteli- Njësinë – PK, mirëpo me pëlqimin paraprak të menaxherit të të paditurës për Regjionin e P....., paditësi kishte filluar të punoj si punëtor Kontrollor i Shpërndarjes nga data 06.08.2014 deri me datën 03.12.2019, mirëpo i njëjti ka vazhduar të punoj me kontratën si punëtor sporteli. Gjykata gjatë shqyrtimit ka provuar se paditësi për punën e kryer si kontrollor i shpërndarjes nuk është paguar asnjëherë në bazë të gradës 6, ku as e paditura këtë fakt nuk e ka mohuar, ku e paditura ka përfituar në llogari të tij, sepse në njërin anë e sistemon paditësin si kontrollor të shpërndarjes me gradën 6, e përfshin në listën e punëtorëve me pozitë të njëjtë, e në anën tjetër nuk e harmonizon kontratën

e punës siç e përcakton ligji, e as nuk kryen detyrimin ndaj paditësit për punën e kryer siç e parasheh ligji.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të ndryshimit në të ardhura personale nga grada 5 dhe 6 për periudhën kontestuese nga data 03.12.2016, deri më datën 03.12.2019, për paditësin ka caktuar ekspertizën financiare nga eksperti financiar U.S, i cili ka konstatuar se diferenca neto e pagesave për periudhën kontestuese është 2,507.34 €, ndërsa kamata ligjore e llogaritur është 551,60 € dhe në total diferenca e neto pagave me kamatë është 3,058.94 €, dhe në emër të kontributit pensional t'ia paguaj shumën prej 146,63 €, për tatimin në burim 278.59 € dhe të refundoj shumën prej 146.63 € në Fondin e Trusti Pensional në të mirë të paditësit. Ekspertizës së ekspertit gjykata i fali besimin pasi që e njëjta është përpiluar në mënyrë profesionale dhe në harmoni me shkresat e lëndës, e gjithashtu në seancën e datës 23.03.2021, palët kanë deklaruar se nuk kanë vërejtje lidhur me këtë ekspertizë, andaj u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar duke pasur parasysh faktin se me asnjë provë të vetme paditësi nuk e ka argumentuar faktin se i takon kjo shumë. Lidhur me pretendimin e parashkrimit të nenit 87 të Ligjit të Punës nga e paditura nuk qëndron për faktin se paditësi kërkon kompensimin e diferencës nga data 03.12.2016, deri me datë 03.12.2019, që i bie se kemi të bëjmë brenda periudhës 3 vjeçare, andaj një pretendim i tillë nuk qëndron pasi që kemi të bëjmë me kërkesa periodike.

Gjykata e shkallës së parë për mënyrën e vendosjes vendimin e saj e ka mbështetur në dispozitat e nenit 8, 10, 55 paragrafi 2 dhe 87 të Ligjit të Punës, lidhur me kamatën ka vendosur në mbështetje të nenit 378, 378 dhe 382 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së, ndërsa për shpenzimet e procedurës ka vendosur në pajtim me nenin 449, 452 dhe 453 lidhur me nenin 463 të LPK-së, dhe TA të OAK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Pretendimi ankimor i të paditurës se aktgjykimi i atakuar është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e lidhur me nenin 160.4 dhe 5 të LPK-së, se dispozitivi i aktgjykimit është i pa kuptueshëm dhe në kundërshtim me arsyet e dhëna, përkatësisht nuk përmbajnë arsye të mjaftueshme për faktet relevante, e gjithashtu për faktet relevante ekzistojnë kundërthënie në mes të asaj se çka thuhet në arsyet e aktgjykimit mbi përmbajtjen e shkresave dhe procesverbaleve lidhur me deklaratat e dhëna gjatë procedurës, për Gjykatën e Apelit është pretendim i pathemeltë. Aktgjykimi i atakuar është mjaft i qartë si në pjesën e dispozitivit, ashtu edhe të arsytimit, në përputhje të plotë me përmbajtjen e kërkuar me dispozitat e nenit 160 paragrafi 4 dhe 5 të LPK-së. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat duke i kualifikuar në pajtim me normat materialo-juridike, ka nxjerrë përfundimin e drejtë lidhur me vendosjen meritore.

E drejta materiale është aplikuar në mënyrë drejtë në raport me gjendjen faktike të vërtetuar në këtë çështje juridike kontestuese nga ku ka rrjedhë se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë.

Me nenin 55 par 2 i Ligjit të Punës, përcakton se të drejtën për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuari i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me Kontratën e Punës.

Në bazë të legjislacionit në fuqi, paditësi ka themeluar marrëdhënie pune me të paditurën sipas kontratës së punës për kohë të pacaktuar me datën 20.07.2012, si Punëtor Sporteli- Njësinë – PK, mirëpo me pëlqimin paraprak të menaxherit e të paditurës për Regjionin e P....., paditësi kishte filluar të punoj si punëtor Kontrollor i Shpërndarjes nga data 06.08.2014 deri me datën 03.12.2019, mirëpo i njëjti ka vazhduar të punoj me kontratën si punëtorë sporteli.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë gjatë shqyrtimit ka provuar se paditësi për punën e kryer si kontrollor i shpërndarjes nuk është paguar asnjëherë në bazë të gradës 6, ku as e paditura këtë fakt nuk e ka mohuar, ku e paditura ka përfutuar në llogari të tij, e paditura me një veprim të tillë ka cenuar dispozitat ligjore në fuqi konkretisht nenin 8, 10 dhe 55 të Ligjit të Punës se Kosovës, sepse në njërin anë e sistemon paditësin si kontrollor të shpërndarjes me gradën 6, e përfshin në listën e punëtorëve me pozitë të njëjtë e në anën tjetër nuk e harmonizon kontratën e punës siç e përcakton ligji, dhe as nuk kryen detyrimin ndaj paditësit për punën e kryer siç e parasheh ligji. Gjykata vlerëson se përgjegjësia është e punëdhënësit, e jo e punëmarrësit, siç pretendon e paditura se nuk është përfill procedura për transfer për në vend tjetër të punës së paditësit, për gjykatën ky pretendim është i pa pranueshëm, për faktin se transferimi është bërë nga vetë e paditura dhe ky fakt nuk është kontestues nga e paditura, andaj ekziston detyrimi juridik i paditurës ndaj paditësit. Andaj gjykata ankimore vlerëson se në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi e të cekura më lart, dhe Rregulloren e brendshme të paditurës dhe me rastin e mos përfilljes së procedurave të brendshme nga e paditura e jo nga paditësi, gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të ligjshme ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, duke e vërtetuar bazën juridike të kërkesëpadiës.

Lidhur me lartësinë e aprovuar të kërkesëpadiës në mes të gradës 5 dhe 6 gjykata e shkallës së parë në cilësinë e provës materiale ka nxjerrë ekspertizën financiare të datës 18.02.2021, të punuar nga eksperti U.S, me të cilën e ka vërtetuar lartësinë e diferencës së të ardhurave që do ta realizonte paditësi në mes të gradës 5 dhe 6m të cilën diferencë nuk ia ka paguar e paditura paditësit, përkundër faktit që vetë e paditura e ka transferuar në pozitën e kontrollorit të postierëve dhe të shpërndarjes. Në këtë mënyrë gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike edhe sa i përket lartësisë së të ardhurave personale të paditësit në mes gradës 5 dhe 6 dhe atë për ndryshimin e pagës, bonusit dhe të trustit, për të cilat edhe Gjykata e Apelit ia fali besimin pasi që e njëjta ekspertizë është përpiluar në mënyre profesionale dhe në harmoni me shkresat e lëndës dhe gjithashtu në seancën e datës 23.03.2021, palët kanë deklaruar se nuk kanë vërejtje lidhur me këtë ekspertizë.

Poashtu, Gjykata e Apelit nuk i pranoi pretendimet ankimore të paditurës se kërkesëpadia e paditësit është e paafatshme, pasi që kërkesa e paditësit është kërkesë materiale dhe sipas nenit 87 të Ligjit të Punës, i cili përcakton se të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës, e që në rastin konkret paditësi kërkon kompensimin e diferencës nga grada 5 në gradën 6 për periudhën nga data 03.12.2016, deri me datë 03.12.2019, që i bie se kemi të bëjmë brenda periudhës 3 vjeçare, andaj pretendimi i të paditurës se kërkesa është parashkruar nuk qëndron pasi që kemi të bëjmë me kërkesa periodike dhe duke u bazuar në neni 353 të LMD-së, u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Vendimin mbi kamatën gjykata e ka vendosur në mbështetje të nenit 378 dhe 382 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së.

Vendimi për shpenzimet procedurale është marrë konform dispozitave ligjore neneve 449, 452 dhe 453 lidhur me nenin 463 të LPK-së dhe TA të OAK-së, e në pajtim me veprimet e ndërmarra procedurale.

Gjykata e Apelit nuk e ka shqyrtuar aktgjykimin e atakuar në pikën III të dispozitivit në pjesën e refuzuar të kërkesëpadiës, ngase nuk kishte pretendime ankimore në këtë drejtim.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkëlqje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar të pathemelta.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.3926/2021 të datës 25.04.2024

Kryetare e Kolegjit
Nora Blaca-Dula. d.v.